

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.03.11.2020*

03.11.2020

Ora 12:00

RENDI I DITËS

Shqyrtimi i projektaktit “Për shqyrtimin e kërkesës së komitetit përfaqësues të nismës ligjore, për shtyrjen e afatit për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse për propozimin e projektligjit “Për krijimin e regjistrit kombëtar të autorëve të krimeve seksuale”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

Z.Illirjan Celibashi, Komisioner Shtetëror i Zgjedhjeve

Z.Ylli Merkaj, Sekretar i Përgjithshëm i KQZ-së

Z.Erion Meta, Shef i Sektorit të Dekriminalizimit

Z.Olsi Peto, jurist

Të tjerë:

Z.Erina Leka, shoqëria civile

Z.I.Celibashi: Mirëdita, hapim seancën për shqyrtimin e kërkesës së ardhur nga “Qendra e Këshillimit për Gra&Vajza”, “Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri” dhe “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, sipas të cilës është kërkuar zgjatja e afatit për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse për projektligjin “Për krijimin e regjistrit kombëtar të autorëve të krimeve seksuale”. I japim fjalën Sekretarit ose për një relativitet të shkurtër në lidhje me këtë kërkesë.

Z.Y.Merkaj: Komiteti përfaqësues i nismës ligjvënëse znj.Iris Luarasi përfaqësuese e Qendrës “Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza”, znj.Ines Leskaj përfaqësuese e

*Zbardhi materialin e inçizuar
Stenografia
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.03.11.2020*

shoqatës “Rrjeti i fuqizimit të gruas në Shqipëri” dhe znj. Mirela Arqimandriti përfaqësuese e Qendrës “Aleanca Gjinore për Zhvillim” kanë paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, kërkesën për pajisje me fletë tip për propozimin e projektligjit “Për krijimin e Regjistrit Kombëtar të Autorëve të Krimeve Seksuale”. Kërkesën e tyre përfaqësuesit e nismës ligjvënëse e mbështesin tek paragrafit 4 nenit 6, paragrafit 1 neni 10 të ligjit nr.54/2019 “Për Nismën Ligjvënëse të Zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë”. KQZ, me vendimin nr.13, datë 30.06.2020 vendosi miratimin e fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve sipas kërkesës së komitetit përfaqësues, për propozimin e projektligjit “Për krijimin e Regjistrit Kombëtar të Autorëve të Krimeve Seksuale”. Vendimi i sipërcituar, ka përcaktuar dhe afatin 4 mujor nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, për mbledhjen e nënshkrimeve. Në datën 29.10.2020 pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është protokolluar kërkesa për shtyrjen e afatit të përcaktuar në vendimin nr.13, datë 30.06.2020, për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme nga komiteti përfaqësues i nismës ligjvënëse si dhe ka përcaktuar periudhën kohore për shtyrjen e afatit 6 javë deri në 15 Dhjetor 2020, pasi për shkaqe objektive nuk ka mundur t’i mbledhë nënshkrimet. Për më tepër mund t’i japim fjalën përfaqësueses së komitetit përfaqësues, e cila është me autorizim dhe e pranishme në sallë.

Z.I.Celibashi: Faleminderit! Po fjala është për ju!

Znj.E.Leka: Përshëndetje, unë jam përfaqësuesja e komitetit të nismës ligjvënëse “Për krijimin e regjistrit kombëtar të autorëve të krimeve seksuale”. Ashtu siç u relatua me vendimin nr.13 të datës 30.06.2020 është marrë vendimi për marrjen e

*Zbardhi materialin e inçizuar
Stenografia
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.03.11.2020*

fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve dhe është përcaktuar periudha 4-mujore për mbledhjen e këtyre nënshkrimeve. Ndryshe nga sa ne kishim menduar, nisur nga situata e krijuar për shkak të covid-19, procesi i mbledhjes së nënshkrimeve ka ecur me ritme shumë të ngadalta. Shkak për këtë ka qenë fakti që komiteti përfaqësues i nismës, nuk ka mundur që të bëjë takime publike në mënyrë të tillë që të ndërgjegjësonte dhe të sqaronte për qëllimin e nismës, për çfarë do të parashikohej në projektligj si dhe për mënyrën se si do të funksiononte. Mos zhvillimi i këtyre takimeve, ka bërë që zgjedhësit së pari të jenë skeptikë në lidhje me projektligjin dhe së dyti ka qenë dhe problemi i krijimit të distancimit publik. Ka pasë raste psh në vendin e miratuar nga bashkitë përkatëse që zgjedhësit nuk kanë dashë që të jenë afër personave të tjerë, për shkak të sigurisë së tyre. Kjo ka bërë që deri në këtë moment procesi i mbledhjes së nënshkrimeve të jetë mbi gjysmën e numrit të duhur të tyre. Konsiderojmë se një periudhë 6-javore do të jetë mëse e mjaftueshme për mbledhjen e nënshkrimeve të tjera për të bërë minimumin e kërkuar nga ligji që është 20000 nënshkrime nga zgjedhësit. Theksojmë rëndësinë e projektligjit dhe hapat që janë ndërmarrë deri tani siç është ulja e abuzimit seksual, mbrojtja e viktimave të krimeve seksuale dhe parandalimi që abuzuesit të bëhen recisivistë.

Z.I.Celibashi: Faleminderit, jeni të sigurtë që kjo periudhë që keni kërkuar si zgjatje është e mjaftueshme për ta përmbushur qëllimin tuaj, apo doni më shumë kohë se sa keni kërkuar?

Znj.E.Leka: Mendojmë se po, është e mjaftueshme, faleminderit.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Stenografia
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.03.11.2020*

Z.I.Celibashi: Mirë faleminderit! Atëherë në përfundim, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 19, pika 2 të Kodit Zgjedhor si dhe në nenin 53, paragrafi 3-të të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, vendosi:

1.Të zgjasë afatin për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse për projektligjin “Për krijimin e regjistrit kombëtar të autorëve të krimeve seksuale” deri në datën 31 Dhjetor 2020.

2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

U shpall sot në Tiranë, më 3.11.2020, faleminderit, seanca mbyllet!

Vendimi nr.19

*Zbardhi materialin e inçizuar
Stenografia
Merita DULAKU*

